



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E KAÇANIKUT  
OPŠTINA KAÇANIK

KAÇANIK  
OPŠTINA KAÇANIK

I	Data	15.06.2023	Vende	KAÇANIK
Nj. ord		Numri	Shtoje	
10	-	104/02	-	14340

KAÇANIKU



Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republic of Kosovo

Komuna e Kaçanikut

Opština Kaçanik

Municipal Kaçanik

---

## DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK DHE TURIZËM

### THIRRJE PËR APLIKIM

Grante në kuadër të Programit  
“Gratë në Biznes”

15 Qershor, 2023

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm (DZHET) në Komunën e Kaçanikut, në bazë të nenit 16 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Kaçanikut nr. 01Nr.05-16-39427/16, në kuadër të Programit "Gratë në biznes" shpall këtë thirrje për aplikim për GRANTE të bizneseve lokale mikro dhe të vogla .

Qëllimi i Programit "Gratë në biznes", ka për synim fuqizimin ekonomik të gruas përkatësisht promovimin e ndërmarrësise së grave.

Ky fond do të nxisë dhe mbështesë zgjerimin e bizneseve për punësim të grave.

Shuma e fondit në dispozicion për këtë thirrje është 40,000.00 €

Vlera maksimale e financimit të një granti është 2,000.00 €

- Përqindja e bashkëfinancimit nga aplikantët duhet të jetë 50%, kurse shuma që kërkon nga Komuna e Kaçanikut nuk mund të jetë mbi 50% e kostos totale të projekt propozimit (pra shuma e bashkëfinancimit nga ana e komunës nuk mund të kaloj vlerën 2,000.00 € dhe kosto totale e projekt propozimit nuk duhet të kaloj vlerën 4,000.00 €)

#### **I. KRITERET E APLIKIMIT:**

1. Bizneset duhet të udhëhiqen nga gratë ( tek shoqëritë tregtare me më shumë se një pronar, pronësia e përfaqësuar nga gratë duhet të jetë mbi 51% e aksioneve të kompanisë);
2. Bizneset duhet të janë të regjistruara në ARBK dhe të operojë në komunën e Kaçanikut, ku edhe duhet të bëhet investimi;
3. Bizneset ekzistuese duhet të janë ndërmarrje në pronësi private 100% dhe të regjistruara në Kosovë sipas ligjeve të Kosovës;
4. Biznesi duhet të ketë të punësuar së paku një punonjës;
5. Të gjeneroj punësim me marrjen e grantit;
6. Bizneset duhet të dëshmojnë se janë funksionale, të qëndrueshme në treg dhe kanë kapacitet të mjaftueshëm për zgjerimin e prodhimit, qarkullimit dhe rritjen e numrit të punonjësve;
7. Bizneset të cilat promovojnë ide kreative dhe inovative në tregun tonë do të kenë përparësi;

8. Ndërmarrjet të cilat me blerjen e pajisjeve ofrojnë produkte cilësore të cilat ndikojnë në zhvillimin ekonomik kanë përparësi;
9. Në momentin e aplikimit biznesi duhet të dorëzojë Profaturën /Ofertën për pajisjet dhe mjetet e punës të planifikuara për investim;
10. Bizneset duhet të dëshmojnë se i kanë të paguara obligimet ndaj komunës së Kaçanikut.(Tatimi në pronë, taksën ushtrimit të veprimtarisë së bizneseve etj );
11. Bizneset duhet të dëshmojnë se nuk kanë obligime ndaj Administratës Tatimore të Kosovës(ATK);
12. Biznesi duhet të ketë një qarkullim minimum 2,000.00€ nga viti i fundit kalendarik, të dëshmuara nga ATK;

## ***II. PËRPARËSITË PËR GRANTET GRATË NË BIZNES:***

Gjatë ndarjes së subvencioneve për zhvillim ekonomik, në kushte të barabarta Komuna u jep përparësi rasteve specifike si në vijim:

- 1.1. Bizneseve prodhuase, përpunuase dhe shërbyese që gjenerojnë punësim;
- 1.2. Bizneset të cilat udhëhiqen apo kanë të punësuar persona të cilët i takojnë kategorive me nevoja të veçanta;
- 1.3 . Bizneset të cilat posedojnë dëshmi apo çertifikime profesionale;
- 1.4. Bizneseve që nuk kanë fituar më parë subvencione nga komuna dhe gjatë vitit të njëjtë fiskal nuk kanë qenë përfitues i një subvencion i për zhvillim ekonomik të ndarë nga pushteti qendror ose nga ndonjë donator tjeter.

## ***III. ÇFARË FINANCOHET NGA GRANTI:***

Blerja e pajisjeve dhe mjeteve të punës (Pajisjet duhet të janë të reja). Investime në asete të prekshme që kanë të bëjnë me blerjen e pajisjeve, makinerisë, linjat e prodhimit, që mund t'i ndihmojnë kompanive të janë më pak të varura nga faktorët e jashtëm.

#### ***IV. KRITERET JOKUALIFIKUESE:***

Aplikantët potencialë nuk mund të marrin pjesë në këtë thirrje apo të përfitojnë grant nëse gjenden në ndonjëren prej situatave që renditen si më poshtë:

- Bëjnë pjesë në njëren prej veprimtarive si: tregtia (me pakicë e shumicë, në kuptimin e shit-blerjes), ndërtimtaria, shëndetësia dhe bujqësia;
- Paraqet veti diskriminuese apo ka ndikim negativ në shoqëri dhe komunitet;
- I shkakton dëme ambientit apo ndonjë grupi tjetër të marginalizuar;

#### ***V. PROCEDURA E APLIKIMIT***

Pakoja e Aplikimit mund të merret duke klikuar në ueb-faqen zyrtare të komunës në linkun: <https://kk.rks-gov.net/kacanik/category/konkurset-njoftimet/thirrje-per-propozime/>, si dhe mund të merret pranë Qendrës për Shërbim me Qytetar në objektin e Komunës së Kaçanikut, kati përdhesë.

Pasi ta keni plotësuar aplikacionin, së bashku me dokumentacionin mbështetës që kërkohet, duhet të dorëzohet në formën fizike në Qendrën për Shërbim me Qytetar në objektin e komunës së Kaçanikut, kati përdhes, çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00, ku protokollohet dokumentacioni dhe ju do të merrni numrin e protokollit, që dëshmon se KENI APLIKUAR.

Dokumentet duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur .

Një aplikant nuk mund të dorëzojë më shumë se një aplikacion në këtë thirrje.

#### ***VI. AFATI I APLIKIMIT:***

Afat i fundit për aplikim është deri më datë: 12.07.2023 ora 16:00.

## **VII. DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR APLIKIM:**

Pakoja e aplikimit e cila përban dokumentet si ne vijim:

- Formulari i aplikimit ;
- Deklarata nën betim nga aplikanti ;
- Kopje e letërnjoftimit;
- Kopje e Certifikatës së Biznesit me të gjitha informatat përcjellëse (certifikata duhet të jetë e re, lëshuar nga ARBK sipas numrit unik identifikues);
- Oferta / Profatura me të gjitha shënimet e duhura si: numri i regjistrimit të biznesit, numri i pro faturës, emri i plotë i furnitorit (shitësit), adresa e saktë , nënshkrimi dhe vula e shitësit, dhe të gjitha të dhënat tjera të rëndësishme përfundimtare të pashlyera apo obligime të tjera tatimore, ose është në marrëveshje përfundimtare përfshirë se qëllimi i tij është përmes përkatesës së një kompanie;
- Dëshmi apo certifikime profesionale në fushën që biznesi ushtron aktivitetin e tij;
- Vërtetimi që nuk ka obligime ndaj Komunës së Kaçanikut;
- Konfirmimi Bankar i Biznesit;
- Vërtetimi tatimore me validitet në ditën e aplikimit (jo më i vjetër se 90 ditë) me të cilin vërtetohet se aplikuesi nuk ka borxhe aktuale tatimore të pashlyera apo obligime të tjera tatimore, ose është në marrëveshje përfundimtare përfshirë se qëllimi i tij është përmes përkatesës së një kompanie;
- Lista e punëtorëve përfundimtare përfshirë se qëllimi i tij është përmes përkatesës së një kompanie;
- Deklarata tatimore vjetore përfundimtare përfshirë se qëllimi i tij është përmes përkatesës së një kompanie;

## **VIII. PROCEDURAT E VLERËSIMIT:**

Faza e parë e vlerësimit të aplikacioneve do të përfshijë një “kontroll administrativ” përfundimtare përfshirë se qëllimi i tij është përmes përkatesës së një kompanie. Faza e dytë do të përfundimtare përfshirë se qëllimi i tij është përmes përkatesës së një kompanie. Faza e tretë do të përfundimtare përfshirë se qëllimi i tij është përmes përkatesës së një kompanie.

## **IX. FORMA E PAGESËS SË GRANTIT:**

*Shuma e financimit te fondeve publike komunale përfundimtare përfshirë se qëllimi i tij është përmes përkatesës së një kompanie.*

**Maksimumi nga 2,000.00 €**

Grantet jepen në formën e parave të gatshme, pasi që biznesi sjell dëshminë respektivisht faturën e rregullt për blerjet (investimet) që i ka bërë, e të cilat duhet të janë në përputhshmëri të plotë me kërkesën për investim që e ka dëshmuar me profaturë/ofertë.

Profatura që biznesi e paraqet gjatë aplikimit dhe fatura e rregullt që biznesi e merr pasi të ketë blerë paisjen duhet të ketë përputhshmëri të plotë njëra me tjetrën, në asnjë formë nuk lejohet ndryshimi i specifikave të pajisjes.

**Sqarim:**

Në rast se jeni përzgjedhur përfitues i grantit, nënshkruhet marrëveshja me Komunën/DZHET dhe pastaj duhet të sjellët **Fatura dhe transferi bankar** i bërë nga xhirollogaria e biznesit tuaj tek operatori ekonomik (fumitor), me të cilën dëshmohet blerja e pajisjes/ve dhe pastaj Komuna e bënë rimbursimin e mjeteve financiare në vlerën e grantit.

Kohëzgjatja e planifikuar e zbatimit nuk mund të tejkalojë 2 muaj.

**Vërejtje:**

Nga momenti i nënshkrimit të marrëveshjes me secilin përfitues, përfituesi është i obliguar që ti përbahet kushteve të marrëveshjes, vlen të ceket që përfituesi nuk ka të drejtë që pajisjen ta ndërroj, shesë apo të huazoj tek pala tjetër në afate kohor prej 5 vite duke filluar nga data e nënshkrimit të marrëveshjes .

Pas nënshkrimit të marrëveshjes për secilin përfitues, formohet komisioni nga ana e Komunës së Kaçanikut, komisioni i cili monitoron gjendjen faktike në teren dhe në rast të keqpërdorimit eventual do të ndiqen rrugët ligjore.

